

**SHALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të VKM nr.243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil për pozicionin:

- **1 (një) Specialist në Sektorin e Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - Kategoria III-b (e barazvlefshme me klasën IV-1¹).**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se pozicioni, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

LËVIZJE PARALELE

13/11/2023

Afati për dorëzimin e dokumenteve për:

PRANIM NË SHËRBIM CIVIL

19/11/2023

¹ Referuar kreut IV, pika 4, të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike.”

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet është:

- Ofron asistencë për të gjithë personat që paraqiten pranë zyrës ose në telefon për të paraqitur ankesë;
- Ndhmon përgjegjësën e sektorit në lidhje me dokumentimin e veprimtarive që organizon Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe që i shërbejnë historikut të institucionit si: takime, konferenca, trajnime simpoziume, pritje delegacionesh apo çdo veprimtari tjetër;
- Siguron përgatitjen e materialeve apo shkresat e ardhura në institucion apo ato të cilat do t'ju drejtohen të tretëve sipas porosive të eprorëve;
- Krijon, zhvillon dhe mirëmban faqen zyrtare në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të plotë dhe shterues në lidhje me ecurinë që ndjek ankesa nga momenti i regjistrimit, deri në vendimmarrjen përfundimtare, si dhe ofron informacion mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Monitoron mediat audiovizive dhe/ose on-line për raste denoncimesh publike ose shkelje të pretenduara nga magjistratë, në përputhje me parashikimet ligjore;
- Mundëson informacione në faqet e internetit me pyetjet e shpeshta dhe përgjigjet me zyrtare me e-mail dhe/ose me postë;
- Kontrollon dhe garanton të drejtën e informimit të qytetarëve dhe transparencën me publikun;
- Bën publike aktet administrative individuale të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Ndjek gjurmueshmërinë e ankesave nëpërmjet sistemit dhe japin përgjigje për fazën ku ndodhet ankesa e veçantë.

1-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (vërtetuar me dokument nga institucioni);
- c) Të kenë të paktën një vlerësim fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në Gazetari/ Shkenca Komunikimi/ Shkenca Juridike/ Shkenca Sociale/ Shkenca Politike/ Gjuhë Letërsi/ Gjuhë e Huaj, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit.
- c) Të kenë njohuri të njërës prej gjuhëve zyrtare të BE-së (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht).

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, linku: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- f- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, linku: <https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- i- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (për kandidatët në marrëdhënie pune 6 mujori i parë i vitit 2023);
- j- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, kati 3, (tek Avokatura e Shtetit), Tiranë, brenda datës **13.11.2023**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s’ kualifikim të kandidatit.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14.11.2023** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e

lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e mos kualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Njohuritë mbi ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015 “Për

procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike, faqa zyrtare www.dap.gov.al

Linku: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët do të paraqiten në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen Paralele, brenda 3 ditëve kalendarike nga njoftimi individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

2- PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

*Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data **04.12.2023**.*

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në Gazetari/ Shkenca Komunikimi/ Shkenca Juridike/ Shkenca Sociale/ Shkenca Politike/ Gjuhë Letërsi/ Gjuhë e Huaj, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit.
- c) Të kenë njohuri të njërës prej gjuhëve zyrtare të BE-së (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht).

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, linku;
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, linku;
<https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- h- Vërtetim nga gjykata;
- i- Vërtetim nga prokuroria;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, kati 3, (tek Avokatura e Shtetit), Tiranë, brenda datës **19.11.2023**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s’ kualifikim të kandidatit.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **04.12.2023**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit për shkaqet e mos kualifikimit, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr.9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë), nga vlerësimi me pikë, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit.

Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike, faqja zyrtare www.dap.gov.al

Linku: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail, mbi rezultatin vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit, si dhe për intervistën strukturuar me gojë.

Ankesat nga kandidatët, do të paraqiten në Komitetin e Përhershëm të Pranimin, brenda **5** ditëve kalendarike nga njoftimi individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të afatit të ankimimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit. Kandidatë fitues janë kandidatët që kanë marrë mbi 70 pikë (70% të pikë), duke u renditur nga kandidati me rezultatin më të lartë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimin në shërbimin civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit, duke filluar nga data: **04.12.2023**